



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe
Shërbime Publike

Nr. ____ /2023 Dt. 12 /12/2023

RAPORT VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2023

Sektori i Shërbimeve Publike

	OPSTINA DEÇAN REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E DEÇANIT / OPSTINA DEÇANE / DEÇAN MUNICIPALITY	
Nr. i Dreg.:	Dreg. për:	Dreg. për:
	Drej. Mb. Sh. Publike	618
Nr. i Dreg.:	Dreg. për:	Dreg. për:
	09	05.01.24
No. i Dreg.:		

E përgatiti :
Shefi i Sektorit për Shërbime Publike

Xhevat Lufaj



Miratoi :
Drejtori për D.M.SH.SH.P.

Izet Zenuni

HYRJE

Drejtoria për M.SH.SH.P në organizimin e saj udhëhiqet nga Drejtori dhe ka dy sektorë : Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe Sektori për Shërbime Publike.

Sektori për Shërbime Publike në kuadër të organizimit dhe të strukturës së tij mbi punën dhe aktivitetet, është i organizuar më organogram: Shef i sektorit të Shërbimeve Publike , Zyrtar për ndërtim, Zyrtar për Transportin Publik, Zyrtar për Menaxhimin e mbeturinave, duke kryer edhe punë dhe detyra tjera shtesë që dalin nga drejtoria.

Sektori i Shërbimeve Publike sipas planifikimeve vjetore nga drejtoria , detyrat parësore kanë qenë realizimi i projekteve në infrastrukturën rrugore, ndërtimi dhe mirëmbajtja e tyre, menaxhimi i mbeturinave, mirëmbajtja dhe zgjerimi i ndriçimit publik, ndërtimi i trotuareve, shesheve, ndërtim dhe mirëmbajtje të kanalizimit, mirëmbajtjen e varrezave publike si dhe ndërtimin e lapidareve të Dëshmorëve, kujdesi për hapësirat publike në tërë territorin e komunës së Deçanit, kanalizimin e qytetit dhe detyra të tjera dytësore që dalin gjatë vitit. Po ashtu pjesë e aktiviteteve janë edhe punët e përbashkëta që janë me ndërmarrjet komunale dhe regjionale siç është, Kompania NPL "Higjiena", Kompania regjionale e ujësjellësit "Hidrodrini", Ndërmarrja regjionale për ujitje të tokave "Drini i Bardhë". Sektori i Shërbimeve Publike po ashtu ka bashkëpunim me KEDS-in - Njësia Deçan.

Koordinim dhe bashkërendim të punëve dhe aktiviteteve, me theks të veçantë ka pasur me NPL "Higjiena", ku shumicën e punëve të menaxhimit të mbeturinave dhe mirëmbajtjes së hapësirave publike, mirëmbajtjen dhe rregullimin e varrezave dhe lapidarëve të Dëshmorëve, i ka kontraktuar me kontratën "Në Shtëpi".

Raporti vjetor i punës do të bartë në vete të gjitha të dhënat për punët e kryera, në formë tabelare dhe tekstuale gjatë gjithë vitit siç kanë qenë të planifikuara gjatë vitit paraprak.

1. Infrastruktura rrugore dhe mirëmbajtja gjatë vitit 2023



1.1 Asfaltimi i rrugëve në territorin e Komunës së Deçanit - 2023

Nr.	Vendi dhe emri i rrugës	km
•	Fshatrat Shaptej-Dubravë (LOT 3)	6 km
•	Rruga "Ura e Demës"- Deçan deri të Rruga e Gashit - Isniq	1.5 km
•	Rrugë anësore në Isniq	2.5 km
•	Asfaltimi i parkingjeve në hapësira publike të çerdhja e fëmijëve, të qendra rinore dhe pranë Rrugës "Jashar Salihaj" (në oborrin e banesave të përbashkëta).	0.26 km
•	Asfaltimi i rrugicave në fshatin Strellc të Epërm	4 km
	Rruga "Garda e Dukagjinit" - Kodrali, zgjerimi, trasimi dhe mbushja me zhavorr, muri mbrojtës(120 m)	1.2 km
	Gjithsej:	<u>15.46 km</u>

1.2 Projektet

	Projektet	Të dhënat shtesë
▪	Ndërtimi i rrethojave te objekti i “Higjienës” dhe Qendra Rinore	në vazhdim
▪	Ndërtimi i Objektit të kolonisë se artisteve	
▪	Ndërtimi i Qendrës Rinore – Faza II-të	
▪	Enterieri i Kolonisë së Artisteve	
▪	Renovimi i objektit te zjarrfikëseve	
▪	Asfaltimi dhe rregullimi i infrastrukturës së çerdhes në Deçan	
▪	Pishina gjysme olimpike	në vazhdim
▪	Shtëpiza turistike – faza e II-të	në vazhdim
▪	Elektrifikimi i bjeshkës së Belegut	në vazhdim
▪	Ndërtimi i rrethojave dhe trotuarit tek Shkolla e Belegut	
▪	Rikonstruktimi i rrugëve të bjeshkës	
▪	Asfaltimi i rrugëve në Belle, faza e parë,	në vazhdim
▪	Përgatitja për asfaltim të rrugës në fshatin Pleqe	në vazhdim
▪	Ndërtimi i rrugës Bjeshka e Madhe (Laku i Kryqës) – faza e parë	në vazhdim
▪	Ndërtimi i rrjetit të kanalizimit dhe impiantit për fshatin Drenoc	
▪	Deçan, rr. “Manastiri” shëtitörja, kanali, muri mbrojtës, ulëset si dhe ndriçimi.	

2. Punët e kryera sipas kontratës “Mirëmbajtja e rrugëve të Bjeshkëve”

	Vendi dhe emri i rrugës	Km te krasitjes	Km trasim dhe gërryerje
•	Prerja e vegjetacionit, zgjerimi dhe gërryerja rr. “Degëzimi nga Rampa deri tek Bjeshka e Deçanit” si dhe “Stanishta e Kurvalles deri te “Stanishta e Zogut”	13.0	9.2
•	Prerja dhe krasitja e degëve të pemëve që pengojnë rrugën në të dyja anët në aksin, gërryerje tek: “Ruga e Bjeshkës së Deçanit dhe Bjeshkës së Carrabregut” si dhe rr. “degëzimi nga Zalli i Rupes deri te Pllaqica e Vokshit” dhe “Ruga në Bjeshkën e Belles së Ulët”	15.5	2.5
•	Prerja dhe krasitja e degëve të pemëve që pengojnë rrugën në të dyja anët dhe zgjerimi e gërryerja e rrugës ekzistuese në aksin: “Nga Laura te Bjeshka e Kurvalles” , rruga në “Bjeshkën e Prilepit” si dhe rruga në “Bjeshkën e Pleqes”	18.0	6.0
•	Prerja dhe krasitja e degëve të pemëve që pengojnë rrugën në të dyja anët në aksin “Ruga në bjeshkën e Roshkodolit”	10.0	0

3.Ujësullësi

	Vendi	km
•	Bjeshka e Belegut	5.5
Shënim: Projekt në vazhdim		2.5- 3.0

4.Mirëmbajtja dhe zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik

Edhe gjatë vitit 2023, ka vazhduar zgjerimi i ndriçimit publik eficient në fshatrat dhe vendbanimet e Komunës së Deçanit.


Zgjerimi i Ndiriçimit publik në Komunën e Deçanit mbulon rreth 90 % të territorit të tij, rrugë të ndriçuara janë rreth 94 km.

Vendbanimet që kanë përfunduar shtrirjen e rrjetit janë: Baballoq, Carrabregu i Epërm, Dashinoci, Duboviku, Gramaqeli, Lëbusha, Lumbardhi, Lluka e Epërme, Prapaqani, Rastavica, Shaptej, Ledina, Jasiq i Ri, ndërsa në qytetin e Deçanit është bërë zëvendësimi i trupave ndriçues me trupa eficient e cila ka ndikuar në reduktimin e shpenzimeve të energjisë elektrike të ndriçimit publik.

Projekti vazhdon dhe planifikohet që të behet ndriçimi edhe i vendbanimeve tjera të mbetura si Hulaj, Vranoc i Vogël ,Papiq , Ratish i Eperm, Ratish i Ulët dhe Maznik.

Me anë të kontratës për mirëmbajtjen e ndriçimit publike kemi pasur intervenime të vazhdueshme në rrjetin ekzistues të ndriçimit publik dhe në institucioneve publike.

5. Aktivitetet e Komunës bashkë me NPL “Higjiena” -Kontrata “Në shtëpi”



Ndër aktivitetet kryesore për vitin 2023, Komuna e Deçanit konkretisht Sektori për Shërbime Publike e ka pasur me Ndërmarrjen Publike Lokale “ Higjiena” me punët e kontraktuara sipas kontratës “Në Shtëpi”.

Me poshtë do ti paraqesim punët dhe aktivitetet në shumë fusha së bashku me N.P.L. Higjiena si:

5.1 Mirëmbajtja e hapësirave publike

Mirëmbajtja e hapësirave publike duke përfshirë mbjelljen, ujitjen, mirëmbajtjen e mobilerisë urbane, riparimi i shtigjeve me kubëza, pastrimi dhe fshirja e rrugëve kryesore dhe trotuareve në qytet, vendosja e tabelave për emërtimin e rrugëve, kositja e parqeve si dhe pune me ekskavator sipas kërkesës së Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Sh. Publike

5.2 Dekorimi i qytetit për festat zyrtare dhe festa tjera

Dekorimi i qytetit për të gjitha festat zyrtare, vendosja e flamujve, ndërrimi i flamujve, vendosja e shtyllave të flamujve, dekorimi i qytetit për festat e fund vitit dhe dekorime tjera sipas kërkesës dhe nevojave nga D.M.SH.SH.P.

5.3 Mirëmbajtja e kanalizimit

Mirëmbajtja e kanalizimit të ujërave të zeza, gropave septike dhe nyjave sanitare në territorin e Komunës së Deçanit, zhblllokimi i pusetave dhe pastrimi i tyre, zbraza e gropave septike, gjermimi, furnizimi, ndërrimi i gypave deri me funksionalizimin e plotë të ujërave të zeza. Zhblllokimi dhe pastrimi i pusetave të kanalizimit të ujërave atmosferike. Vendosja e kapakëve të pusetave të kanalizimit të ujërave të zeza metalike dhe të betonit etj.

Shënim: Në Tetor të vitit 2023 mirëmbajtja e kanalizimit të ujërave të zeza dhe atyre atmosferike ka kaluar në autoritetin e K.R.U. "Hidrodrini".

5.4 Mirëmbajtja e lapidarëve, memorialëve dhe varrezave të Dëshmorëve dhe varrezave publike

Plani për mirëmbajtjen e lapidarëve, memorialëve dhe varrezave të dëshmorëve, pastrimi, mirëmbajtja e tyre, mbjellja e barit në parqet e tyre, renovimi i pllakave të dëmtuara, mirëmbajtja e hapësirave gjelbëruese përreth kompleksit të dëshmorëve duke përfshirë prerja dhe kositja e barit, largimi i mbetjeve mes pllakave apo gurëve si dhe rregullimi i pemëve dekorative. Ndërrimi i ulëseve, vendosja e ulëseve të reja, shportat e mbeturinave si dhe mirëmbajtja e rrethojave etj. Mirëmbajtja e varrezave publike në gjithë territorin e komunës së Deçanit.

5.5 Eliminimi i deponive ilegale

Gjatë vitit 2023 është bërë eliminimi i deponive ilegale, nivelizimi dhe bartja e tyre në vende të caktuara për deponim. Është bërë largimi i deponive ilegale, rrafshimi dhe mbjellja e barit në ato deponi ku ka qenë e nevojshme.

5.6 Punë dhe aktivitete tjera sipas D.SH.P.-së

Aktivitetet tjera gjatë vitit kanë qenë edhe detyra shtesë të pa planifikuara si: ndërhyrjet në pikat e rrezikut nga vërshimet, pastrimi gjatë vitit i PGM-ve (Pikave të grumbullimit të mbeturinave), kanalet e ujitjes, prerja e vegetacionit etj.

- Transporti Rrugor – Publik

Gjatë vitit 2023 është bërë përcjellja e rregullt e linjave të transportit publik urban dhe rural në qytetin e Deçanit dhe fshatrat e tij.

Është bërë vazhdimi i lejeve dhe licencave për taksitë dhe kombi-busët, që operojnë në Komunën e Deçanit. Mbikëqyrja dhe vendosja e shenjave të komunikacionit si ato horizontale ashtu edhe vertikale sipas planifikimeve dhe nevojave si në qytet ashtu edhe në fshatra.

Bashkëveprim dhe koordinim me Policinë në raste të veçanta dhe kërkesa të ndërsjella. Si dhe punë dhe detyra tjera sipas planifikimit gjatë vitit 2023.

RAPORTI I PUNËS PËR VITIN 2023 SEKTORI I TRANSPORTIT RRUGOR

Nr.	Përshkrimi i detyrave	Jan.	Shk.	Mar	Prill	Maj	Qer.	Korr.	Gusht	Shta	Te.	Ne.	Dhj
1.	Bashkëpunimi me subjektet me rendësi të veçantë Policin e Kosovës, Inspektoratin etj.	1	0	2	0	0	1	0	2	1	0	0	0
2.	Mbikëqyrja dhe kontrolli i masave të parapara ligjore kundër transporteve ilegale dhe të atyre që nuk e respektojnë orarin e përcaktuar nga organi kompetent.	2	0	3	0	0	0	3	1	1	2	0	0
3.	Caktimi i linjave për bartjen e udhëtareve në trafikun urban, vazhdimi i lejeve për transportin e udhëtareve.	0	0	0	0	0	5	3	3	0	1		2
4.	Dhënia e pëlqimit për regjistrimit e taksistëve sipas rregullores së komunikacionit	14 gjatë vitit.											
5.	Kontrollimin e transportit të udhëtareve dhe mallrave	8 gjatë vitit.											
6.	Kontrolli i vendqëndrimeve të caktuara për taxi nga shfrytëzuesit e tyre	10 gjatë vitit											
7.	Mbikëqyr rendin dhe orarin e udhëtimit nga operatorët për transportin e udhëtarëve	1	1	1	1	1	1	1	1	1	0	0	1
8.	Përkujdesja për shënjimin vertikal dhe horizontal të rrugëve lokale.	Gjatë vitit											
9.	Lëshimi i lejeve për vendosjen e pengesave në rrugë që janë kompetencë e Komunës	0	0	2	0	0	2	0	0	0	0	0	0
10.	Lëshimi i vërtetimeve për student dhe punëtorët administrativ;	3	0	4	2	3	3	0	0	0	7	2	2
11.	Përgatitja e procesverbaleve, aktvendime, dhe kërkesa për gjykatat kompetente.												

- Trajnime, Punëtori, Vizitë studimore etj. nga zyrtarët e Sektorit për Shërbime Publike

31 Gusht 2023 - Punëtori lidhur me Menaxhimin e Integruar të mbeturinave-Ekonomia Qarkore- Gjakovë.

6-8 Shtator 2023 -Trajnim: Njoftimi dhe shkëmbimi i përvojave mbi proceset e ndërlidhura me sektorin e menaxhimit të integruar të mbeturinave, bashkëpunimit ndër komunal , raportimit vjetor në AMMK - Istog

9-11 Tetor 2023 - Vizitë studimore ne Shqipëri shoqëruar me vizitë në deponinë me sistemin e integruar të trajtimit të Mbeturinave në Sharra, Tiranë dhe qendrën e kompostimit në Cërrik. .Shkëmbimi i përvojave me Republikën e Shqipërisë në fushën e menaxhimit të integruar të Mbeturinave, përfshirë proceset e ndërlidhura me bashkëpunimin ndër komunal dhe rishikimin e platformës online për raportim vjetor në AMMK.

Data: 12.10.23 - 10h

Vizitë virtuale interaktive e qendrës së riciklimit në Hildesheim/Gjermani

Data: 17.10.23 - 10h

Vizitë virtuale interaktive e qendrës së riciklimit në Hildesheim/Gjermani.

19-20 tetor – 2 ditë

24-26 tetor – 3 ditë

Programi për zhvillimin e kapaciteteve në sektorin e Menaxhimit të Mbeturinave dhe përfaqësuesit e kompanive për menaxhimin e Mbeturinave.

PËRFUNDIM

Drejtoria për Mbrojtje Shpëtim dhe Shërbime Publike – Sektori për Shërbime Publike gjatë vitit 2023 në kuadër të planifikimeve dhe detyrave që ka pas, ka përmbushur dhe realizuar në përgjithësi direktivat e dalura nga Kryetari dhe planifikimi i vitit 2022 i bërë nga drejtoria.

Prioritet dhe vëmendje të veçantë i janë kushtuar ambientit, infrastrukturës rrugore, bashkëpunimit dhe koordinimit me NPL “Higjiena” rreth realizimit dhe përmbushjes së kontratës “Në Shtëpi” menaxhimit të projekteve që kanë qenë në kuadër të Drejtorisë.

Pjesë e aktiviteteve kanë qenë edhe takimet ndër komunale, në nivelet tjera qendrore si me Asociacionin e Komunave të Kosovës, Ministrinë e linjës, Organizatat Qeveritare dhe jo qeveritare që kanë pasur të bëjnë me projektet e Komunës së Deçanit si GIZ, DEMOS, etj.

Vitin e ka karakterizuar pritja e palëve, kërkesat etj. dhe dalja në teren për problemet e caktuara si rrugë, kanalizime, transport publik, mirëmbajtje dhe tema tjera që e lidhin punën dhe aktivitetet e Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike.